

URDHËR
Nr. 661, datë 13.12.2018

**PËR NDALIMIN E HEDHJES NË TREG TË LËNDËVE PIROTEKNIKE DHE
FISHEKZJARRËVE PËR PËRDORIM CIVIL, QË RREZIKOJNË SIGURINË PUBLIKE,
JETËN DHE SHËNDETIN
E QYTETARËVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7 dhe të pikës 3, të nenit 7/1, të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse dhe lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Ndalimin e hedhjes në tregun e brendshëm të artikujve piroteknikë dhe fishekzjarrë për përdorim civil nga publiku i gjerë:

a) Të kategorisë 2 (F2), përdorimi i të cilave në mjedise të hapura jashtë ndërtesave, kërkon një distancë nga 5 deri në 8 metër nga njerëzit dhe objektet;

b) Të kategorisë 3 (F3), përdorimi i të cilave në mjedise të hapura kërkon një distancë mbi 25 metër nga njerëzit dhe objektet.

2. Ndalimin e prodhimit, importit, eksportit, magazinimit, shitjes dhe përdorimit të të gjitha substancave piroteknike dhe fishekzjarrë të cilat përmbajnë squfur, fosfor të përzier me klorat potasiumi, klorate të tjera, apo që përmbajnë njërin nga përzierjet e tilla.

3. Komisioni i Dhënies së Licencave, pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në Ministrinë e Mbrojtjes, të ndalojë prodhimin me qëllim shitjen për treg të brendshëm të artikujve piroteknikë dhe fishekzjarrë për përdorim civil, të kategorisë 2 (F2) dhe të kategorisë 3 (F3).

4. Komisioni i Dhënies së Licencave, pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në Ministrinë e Mbrojtjes, të rishikojë licencat e importit dhe prodhimit të cilat janë në fuqi, për ndalimin e hedhjes në tregun e brendshëm të artikujve piroteknikë dhe fishekzjarrë për përdorim civil, të kategorisë 2 (F2) dhe të kategorisë 3 (F3).

5. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të ndalojë importin e artikujve piroteknikë dhe fishekzjarrë për përdorim civil në tregun e brendshëm të kategorisë 2 (F2) dhe të kategorive 3 (F3).

6. Artikujt piroteknikë dhe fishekzjarrë për përdorim civil, të kategorive 2 (F2) dhe 3 (F3) lejohen të përdoren vetëm nga subjekte të licencuara për përdorimin e lëndëve plasëse, piroteknike dhe fishekzjarrë, në raste festash kombëtare/lokale të organizuara nga institucionet publike, evente festive, ose në rast festash familjare (dasma, ditëlindje), pas vënies në dijeni të Komisariatit të Policisë, që mbulon juridiksionin territorial ku do të zhvillohet aktiviteti.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, si dhe Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, ndërveprojnë ndërmjet tyre me plane të përbashkëta bashkëpunimi.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve/Ekspertë nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në Ministrinë e Brendshme, Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave, si dhe Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, të ngrenë Task-Forcën, e cila të ushtrojë kontrolle për verifikimin e kushteve në linjat

e prodhimit dhe të magazinimit të subjekteve të licencuara për prodhim, import/eksport të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë, sipas fushave të përgjegjësisë.

9. Task-Forca të përbëhet me nga një përfaqësues, të:

- | | |
|---|----------|
| a) Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, | kryetar; |
| b) Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, | anëtar; |
| c) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, | anëtar; |
| d) Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, | anëtar; |
| e) Repartit të Inspektim Shpëtim-Minierave, | anëtar. |

10. Ngarkohen strukturat vendore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, për të kontrolluar dhe verifikuar kushtet e transportit, magazinimit dhe të shitjes në dyqanet sipas juridiksionit territorial dhe fushave të përgjegjësisë, në përputhje me parashikimet e urdhrit nr. 229, datë 8.5.2015, të ministrit të Punëve të Brendshme “Për miratimin e rregullores për mënyrën, kushtet dhe kriteret e magazinimit e të përdorimit të lëndëve piroteknike e fishekzjarrëve”.

11. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve në Ministrinë e Mbrojtjes, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, të bëjë njoftimin e subjekteve të licencuara për import dhe prodhim të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrë. Subjektet e licencuara mund të tërheqin nga tregu dhe të magazinojnë artikujt e përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri, me qëllim përdorimin e tyre, sipas pikës 6, të këtij urdhri ose eksportin e tyre.

12. Bllokimi, magazinimi dhe trajtimi i artikujt piroteknikë dhe fishekzjarrë që ndalohen sipas këtij urdhri, të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi të institucioneve përgjegjëse.

13. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave, si dhe Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

14. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij urdhri, të përballohen nga institucionet e përcaktuara në pikën 13 të tij.

15. Urdhri i përbashkët publikohet për mediet e shkruara dhe vizive nga Ministria e Brendshme.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

MINISTRI I MBROJTJES
Olta Xhaçka

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj